



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
INSTITUTI I SHËNDETTIT PUBLIK

Nr. 1163 Prot.

Tiranë, më 8/10.2020

UDHËZUESI I MASAVE HIGJENO SANITARE COVID-19

NË KINEMA

Ky është një udhëzues i përkohëshëm gjatë kësaj faze dinamike të pandemisë COVID19 dhe për këtë arsye do të rifreskohet sërish sipas nivelit të riskut.

- Administratori i kinemasë vendos grafikun përkatës për organizimin e orëve të aktiviteteve të tij.
- Administratori është i familjarizuar me mënyrën e njoftimit apo të lajmërimit për rast të dyshuar COVID19 gjatë aktivitetit të kinemasë.
- Punonjësit e kinemasë, nëse kanë shenja të infeksionit COVID-19 ose janë kontakt i ngushtë i një rasti pozitiv, nuk duhet të paraqiten në punë dhe të njoftojnë administratorin.
- Në se konstatohet nga stafi rast i dyshimtë me shenja të ngjashme me COVID19, klienti/personeli detyrohet të kthehet në shtëpi dhe komunikon me mjekun e familjes, si dhe stafi njofton administratorin i cili me pas njofton strukturat përkatëse të Njesisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor.
- Nëse identifikohet rast pozitiv me COVID-19 në sallën e kinemasë, operatori do të ndjekë të gjitha udhëzimet për pastrimin larjen dhe dezinfektimin e të gjithë zonës së sallës së kinemasë.
- Asnjë klient me temperaturë mbi 37.5 nuk duhet të lejohet të hyjë në kinema.
- Operatori duhet të afishojë në hyrje si dhe në vende të dukshme në brendësi të subjektit, listën e simptomave të COVID-19 dhe posterin informues mbi uljen e riskut të COVID-19 sipas checklistës së miratuar.
- Të vendosen shenja dalluese në lidhje me distancimin fizik jo më pak se 1.5 m, rreth zonës së ambientit të kinemasë.
- Të afishohen oraret e shfaqjeve me periudha të shkurtra pushimi nga një shfaqje në tjetrën për të parandaluar grumbullimin në zonat e pritjes.

- Të kryhen shfaqjet me një interval pushimi jo më pak se 15 minuta nga njëra shfaqje tek tjetra për të lejuar pastrimin e duhur, për të kryer ventilimin dhe për të parandaluar përplasjen e klientëve që hyjnë /dalin nga kinemaja.
- Të kryhen vetëm rezervime on line dhe të kufizohen grumbullimet në zonën e pritjes për të ruajtur distancimi fizik.
- Të kufizohet dhënia e biletave për anëtarë të një familje në ulëse në rreshta alternative.
- Të mbahet maskë nga klientët dhe nga personeli gjatë gjithë kohës që janë në mjediset e brendshme të kinemasë .
- Të vendoset staf mbështetës për të monitoruar zonat e pritjes ku klientët mund të grumbullohen, në mënyrë që të zbatohet distancimi fizik.
- Të shënohen qartë me shenja dalluese karriget/ndenjësset që nuk përdoren për efekt të ruajtjes së distancës jo më pak se 1.5 m.
- Të merren masat e duhura për dezinfektimin e duarve duke përdorur pastrues me bazë alkooli që përmbajnë të paktën 60% alkool.
- Të favorizohet qarkullimi i ajrit të jashtëm sa më shumë që të jetë e mundur duke hapur dritare dhe dyer.
- Të kryhet higjenizimi i karrigeve, mbështetëseve e krahëve të karrigeve, në raport me numurin dhe oraret e shfaqjeve.
- Të sigurohet higjienë maximale në tualet dhe pajisja me të gjithë elementët bazë higjenik dhe të menxhohen në kohë mbetjet.
- Të mos kryhet konsumim i ushqimeve dhe pijeve në ambjentet dhe sallën e kinemasë.

DREJTOR ISHP

Albana FICO

